



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1289/5 prot.

Tiranë më 05.8.2021

VENDIM

Nr. 37, datë 05.8.2021

**PËR KONTROLLUESIN "AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE
PAJISJEVE MJEKËSORE"**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit "*Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*"

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 88 datë 21.06.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Komisioneri*"), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit "*Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*" (në vijim, "*Kontrolluesi*"), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi, është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe inspektimin e veprimtarive në

fushën farmaceutike. Misioni i tij është i fokusuar në drejtimet si: Garantimi i popullatës me barna të sigurta, cilësore dhe efikase, kontrolli i prodhimit, import-eksporteve dhe shpërndarjes së barnave, kontrolli dhe analiza e cilësisë së barnave që qarkullojnë në treg, monitorimi i efikasitetit të barnave të përdorura, garantimi i tregimit të barnave me çmime të unifikuara dhe lufta kundër kontrabandës, informimi dhe sensibilizimi i popullatës, institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve të shëndetit, transparenca, mosdiskriminimi, barazia, nxitja e konkurrencës në të gjitha procedurat që ndjek institucioni, etj.

2. Kontrolluesi, nuk ka publikuar "*Politikën e Privatësisë*" në faqen zyrtare <https://akbpm.gov.al>, në zbatim të nenit 18 të Ligjit. Nga verifikimi i kryer rezultoi se kontrolluesi nuk ka realizuar gjithashtu informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), në hyrje të ambientit, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 mbi "*Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 3*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi kryhet në mënyrë manuale apo elektronike dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë "*Politikat e Privatësisë*", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i politikave të privatësisë përmbush më së miri qëllimin e informimit.

3. Kontrolluesi disponon kontrata shërbimi me palë të treta të tilla si: Kontratë Shërbimi me "*TOK Digital Agency SHPK*", me objekt: "*Shërbimi i mirëmbajtjes së faqe zyrtare në internet www.akbpm.gov.al*" si dhe kontratë shërbimi me Shoqërinë "*Illyrian Guard*" SHA.

Në kontratat e lidhura nuk parashikohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, mbi "*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*", i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 19*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr. 19.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të Zyrës së Komisionerit dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezulton se Kontrolluesi e ka përmbushur detyrimin për njoftim, në zbatim të nenit 21 të Ligjit. Megjithatë, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit konstatohet se është i nevojshëm përditësimi sa i përket:

- Deklarimit në rubrikën 1, “*Të dhënat e subjektit kontrollues*”;
- Deklarimit në rubrikën 7, “*Marrësi i të dhënave personale*”;

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale është i rëndësishëm, pasi i jep mundësi subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimit ligjor të Kontrolluesit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre ligjore.

5. Kontrolluesi nuk disponon rregullore mbi përpunimin e të dhënave personale si dhe nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet në nenin 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në cilën të parashikohen rregullat dhe procedurat organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të ligji, pasi shmang pasoja të rënda që mund të vijnë për subjektin e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, në datën 15.07.2021, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga Kontrolluesi me pretendimin “*U njoha me konstatimet e grupit të inspektimit sipas procesverbalit. Kërkojmë një afat prej 3 ditësh pune për të parashtruar pretendimet dhe argumentet tona në lidhje me çështjet e trajtuara më sipër*”.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të “*Kodit të Procedurave Administrative*”, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 22.07.2021, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi mori pjesë në seancë dëgjimore dhe nëpërmjet shkresës nr. 4320/4, datë 21.07.2021 paraqiti pretendimet e më poshtme:

- Në lidhje me konstatimin se *“Kontrolluesi nuk ka publikuar politikat e privatësisë”* në faqen zyrtare, sqarojmë se ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar nuk parashikon shprehimisht detyrimin për publikimin e *“Politikave të Privatësisë”*. AKBPM ka ndërtuar për herë të parë faqen zyrtare në vitin 2011 dhe në mënyrë periodike ka përditësuar faqen vit pas viti.
- Në lidhje me konstatimin se *“Kontrolluesi nuk ka parashikuar detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të ligjit dhe të Udhëzimit 19 në kontratat me palët e treta”*, sqarojmë se kontratat publike lidhen në bazë dhe zbatim të Ligjit për Prokurimin Publik dhe në këto kontrata janë të mirëpërcaktuara detyrimet kontraktore mes palëve. Në këto kushte kontratat tip nuk lenë hapësirë për ndryshime jashtë formatit të miratuar.
- Në lidhje me konstatimin se *“Kontrolluesi është përgjegjës për përditësimin e formularit të njoftimit sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të ligjit”*, sqarojmë se AKBPM e ka respektuar detyrimin për njoftim dhe ka përcjellë zyrtarisht pranë Zyrës së Komisionerit me shkresën nr. 3752/1 Prot., datë 25.11.2011. Në këto kushte përditësimi i të dhënave të formularit të njoftimit, i cili nuk prek qenësishëm të dhënat për kategoritë e subjekteve nuk është në fakt shkelje administrative në kuptim të nenit 21 të ligjit.
- Në lidhje me konstatimin se *“Kontrolluesi nuk disponon rregullore mbi përpunimin e të dhënave personale, sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të ligjit”*, sqarojmë se ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar nuk parashikon shprehimisht detyrimin për hartimin e një rregulloreje të posaçme në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Në këtë kontekst, në Rregulloren e Brendshme nr. 264, datë 25.09.2017 *“Për organizimin dhe funksionimin e AKBPM”* rezulton të jenë respektuar detyrimet e nenit 27 të ligjit.

Sa i takon pretendimit të parë, Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues është i detyruar të informoj subjektet e të dhënave për qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat, personin që do kryej këtë përpunim dhe për mënyrën e përpunimit. Ky detyrim është i sanksionuar në nenin 18 të ligjit dhe në Vendim Nr. 6, datë 05.08.2013 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*, ku në pikën 5 përcaktohet se, çdo Kontrollues detyrohet *“Të hartojë dhe zbatojë politikën e privatësisë”*.

Lidhur me pretendimin e dytë, Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesi i ka të gjitha mundësitë që kontratatve tip të cilat janë të miratuara tashmë dhe nuk lenë hapësirë për rregullime të mëtejshme, t'u bashkëlidhë një aneks kontratë ku të parashikohen detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të ligjit. Kontrolluesi mund të bazohet

te modeli i aneks kontratës që ndodhet në Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit ose të hartojë një kontratë të dytë vetëm për respektimin e detyrimeve të përcaktuara në ligj.

Lidhur me pretendimin e tretë, Zyra e Komisionerit vlerëson se njoftimi dhe përditësimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale është një proces i rëndësishëm dhe i pandarë. Kontrolluesi, nuk mund të mjaftohet vetëm me njoftimin përpara fillimit të përpunimit, por duhet të ketë në vëmendje të vazhdueshme përditësimin e tij, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 21 të ligjit “...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

Lidhur me pretendimin e katërt, Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të ligji.

Ky detyrim nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm me standardet e përcaktuara nga Kontrolluesi në rregulloren e tij të brendshme për funksionimin e institucionit, pasi kërkohet një rregullim i plotë në cilën të parashikohen rregullat dhe procedurat organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., Fakti që kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullim të tillë konsiderohet një shkelje serioze e nenit 27 të ligjit si dhe e Vendimit Nr. 6, datë 05.08.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”, ku në pikën 3 përcaktohet se, çdo Kontrollues detyrohet “Të hartojë dhe miratojë rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, mbështetur në projekt/rregulloren tip të hartuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të nenit 39, pika 1, gjerat “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit , që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimet për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuar përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 150 000 lekë.

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 20, 21, 27, 29, 30, 39 pika 1, germa "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e "*Politikave të Privatësisë*" në faqen zyrtare <https://akbpm.gov.al>, në zbatim të nenit 18 të Ligjit;
3. Kontrolluesi të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit përkatës, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19;
4. Kontrolluesi në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të kryejë përditësimin e "*Njoftimit*", në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
6. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
7. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky

Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.

8. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 02.08.2021.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

